



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**UDHËZIM
Nr. 3, Datë 08. 03. 2007**

**PËR
PËRMIRËSIMIN E PUNËS DHE KONTROLLIT TË PROKURORIT NË
NDJEKJEN PENALE**

Me synim,

- për të përmirësuar punën e prokurorit dhe kontrollin e tij në ndjekjen penale;
- për të shmangur praktikatat e gabuara dhe unifikuar punën e prokurorit dhe kontrollin e tij në hetimet paraprake.

Në mbështetje, të nenit 24 pika 4 e vijues të K. Pr. Penale, të nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737, datë 12. 02. 2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Të përmirësohet kontrolli dhe pjesëmarrja e prokurorit në kryerjen e veprimeve hetimore të rëndësishme nga policia gjyqësore, veçanërisht për vepra penale të rënda, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së veprimeve hetimore të rëndësishme dhe në formulimin e akteve përkatëse të kryera prej tyre.

1.1 Konstatimet e prokurorit në kontrollin periodik të akteve të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore dhe i zbatimit të detyrave të caktuara prej tij, të dokumentohen me një akt të shkruar, i cili të ruhet në fashikullin e prokurorit.

2. Njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit janë veprime hetimore të prokurorit, të cilat duhet të kryhen nga ai vet dhe përjashtimisht me urdhër delegimi të posaçëm¹ të tij mund të kryhen nga oficeri i policisë gjyqësore.

2.1 I pandehuri duhet dëgjuar nga prokurori, për të vlerësuar pretendimet e tij dhe për të vendosur se çfarë duhet të bëhet me to.

2.2 Nuk duhet të ndodhë që prokurori të shikohet me të pandehurin vetëm në sallën e gjyqit.

¹ Shih, nenin 304/2 të K. Pr. Penale

3. Njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit nga prokurorët duhet të kryet vetëm kur ka të dhëna të mjaftueshme për marrjen e tij si të pandehur².

3.1 Kur nuk ka të dhëna të mjaftueshme për marrjen e personit të pandehur, nuk duhet nxituar për njoftimin e akuzës dhe pyetjen e të pandehurit.

3.2 Deri në administrimin e të dhënave të mjaftueshme, personi që do të akuzohet mund të qëndrojë në cilësinë e personit nën hetim³.

4. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të respektojnë me rigorozitet parashikimet ligjore dhe nënligjore⁴, për regjistrimin e veprës penale dhe afatet e përfundimit të hetimeve⁵. Ata **duhet të kenë angazhimin dhe përgjegjësinë e duhur**, për të përfunduar hetimet paraprake në afate sa më optimale, **duke i dhënë secilit procedim aq kohë sa është e nevojshme**, për grumbullimin e të dhënave, lidhur me kryerjen e veprës penale dhe për të individualizuar autorin e saj.

4.1 Hetimet paraprake duhet të përfundojnë brenda tre muajve nga data, në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprës⁶. Prokurorët **duhet të mbikëqyrin përfundimin e hetimeve brenda afateve ligjore**, duke mos toleruar zvarritje apo ndërprerje të pamotivuara të veprimeve hetimore.

4.2 Kur të pandehurit janë të paraburgosur, veçanërisht kur ata janë të mitur, gra apo të moshuar, hetimet paraprake duhen përfunduar në kohën më të shkurtër të mundshme. Kontrolli i drejtuesit të Prokurorisë dhe i prokurorëve të strukturave përkatëse të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në procedimet ndaj personave me masë sigurimi "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi".

5. Afati i hetimeve paraprake⁷, mund të zgjatet, vetëm në raste të veçanta, siç mund të jenë - hetime voluminoze dhe të vështira, - me disa të pandehur, - për krime të rënda dhe - për procedime të lidhura me juridiksione të tjera brenda ose jashtë vendit. Nuk duhen dhënë zgjatje të afatit të hetimit pa arsye të forta dhe objektivisht të justifikueshme.

5.1 Në këto raste **zgjatja e afatit duhet të bëhet me vendim të arsyetuar të drejtuesit të prokurorisë**, për një kohë deri në tre muaj por jo më shumë se nga një muaj për çdo zgjatje, ndërsa në rastet e hetimeve komplekse ose për krime të rënda jo më shumë se nga dy muaj për çdo zgjatje, brenda afatit ligjor maksimal të hetimit dhe afatit të kohëzgjatjes së paraburgimit.

² Shih, nenin 34 të K. Pr. Penale

³ Shih, vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 03, datë 27. 09. 2002, F. Zyrtare Nr. 93, viti 2002, për të kuptuar pozitës procedurale të "personit, të cilit i atribuohet vepra penale", "personit nën hetim" dhe "të pandehurit",

⁴ Shih, nenet 287, 323 e 324 të K. Pr. Penale dhe Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005 "Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale"

⁵ Shih, udhëzimet/porositë e dërguara me qarkoren nr. 9, datë 06. 01. 2004 "Për respektimin e afatit të hetimeve paraprake dhe afateve të tjera procedurale", për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë udhëzim

⁶ Shih, neni 323 i K. Pr. Penale

⁷ Shih, po aty, neni 324.

5.2 Pesë ditë para se të përfundojë afati i hetimeve paraprake, mbi kërkesën/relacionin e oficerit të policisë gjyqësore që kryen hetimin, prokurori që ndjek çështjen i parashtron drejtuesit të Prokurorisë kërkesë/relacion për zgjatjen e afatit të hetimeve **duke sqaruar në të:**

- rezultatet e hetimeve deri në atë fazë;
- arsyet pse hetimet paraprake nuk kanë përfunduar në afat;
- arsyet pse kërkohet zgjatja e afatit të hetimeve,
- cilët janë veprimet hetimore që duhet të kryhen dhe;
- sa afat kërkohet për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore.

5.3 Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë duhet të vlerësojnë drejtë nevojën e zgjatjes së afatit të hetimeve dhe të evidentojnë përgjegjësinë e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për mos kryerjen e detyrave të hetimit në afatet ligjore ose në afatet e caktuara nga prokurori.

5.4 Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore i autorizuar prej tij, vendimin e zgjatjes së afatit të hetimeve duhet Via njoftojë të pandehurit ose avokatit mbrojtës të tij në rastet e hetimit në mungesë, si dhe të dëmtuarit, për t'iu garantuar të drejtën e ankimit dhe për të shmangur pavlefshmërinë e veprimeve që mund të kryhen pas zgjatjes së afatit të hetimeve nëse nuk respektohet ky rregullim ligjor⁸.

5.5 Në përfundim të hetimeve, kur vendoset dërgimi i çështjes në gjykatë dhe është vendosur zgjatje e afatit të hetimeve, prokurori në fashikullin e gjykimit duhet të vendosë edhe aktet/vendimet e zgjatjes së afateve të hetimeve paraprake⁹.

6. Në rastet kur të pandehurit janë të arrestuar në flagrancë hetimet të përfundohen nga prokurori brenda 48 orëve dhe të kërkohet bashkë me caktimin e masës së sigurimit edhe **gjykimi i drejtpërdrejtë**, me përjashtim të rasteve kur prokurori vlerëson se duhet të bëhen hetime të tjera.

6.1 Në të njëjtën mënyrë sa më sipër duhet vepruar nga prokurori edhe kur i pandehuri ka pohuar kryerjen e veprës penale dhe fajësia e tij është e qartë, duke përfunduar hetimet brenda 15 ditëve dhe duke kërkuar gjykimin e drejtpërdrejtë.

6.2 Nuk duhet pranuar justifikimi se nuk arrihet marrja e dëshmisë së penaltetit, sepse se kjo nuk është e pamundur. Gjykimi i drejtpërdrejtë nuk do të thotë që gjykimi mbaron në një seancë. Ai zhvillohet si gjykimi i zakonshëm dhe dëshmia mund të merret më vonë, kur është e domosdoshme, ashtu siç mund të bëhet një ekspertim apo eksperiment që nuk është bërë gjatë hetimeve.

7. Të respektohen rigorozisht parashikimet ligjore për **ruajtjen e sekretit dhe publikimin e akteve të hetimit.**

7.1 Prokurorët duhet të nxjerrin urdhër për ruajtjen e sekretit të akteve të veçanta procedurale penale që dokumentojnë rezultatet e veprimeve hetimore, publikimi i të cilëve çmohet se mund të dëmtojë

⁸ Shih, po aty, neni 324/3-4

⁹ Shih, po aty, neni 332

vazhdimin e hetimeve¹⁰. Ruajtja e sekretit për akte procedurale të caktuara mund të vazhdojë deri në përfundim të hetimeve.

7.2 Në rastet kur oficeri¹¹ ose agjenti i policisë gjyqësore, nxjerr sekretin e hetimit ose të dhëna të tjera me karakter konfidencial, duke raportuar mbi hetimin jashtë zyrës së prokurorit, kur nuk është vepër penale, përbën shkelje të disiplinës në ushtrimin e detyrës¹² dhe për këtë duhet të fillojë procedimi disiplinorë ndaj tyre.

7.3. Në hetimet paraprake, gjatë pyetjes në themel të të pandehurit ose personit nën hetim, prokurorët ose oficerët e policisë gjyqësore që u është deleguar kjo e drejtë nga prokurori, duhet të njohin ata gradualisht me provat e fajësisë që ekzistojnë në ngarkim të tyre, në përputhje me nenin 39 pika 1 të K. Pr. Penale.

7.3.1 Gjatë njohjes graduale të të pandehurit me provat e fajësisë, duhet të bëhet kujdes, veçanërisht për krime të rënda, që fillimisht atij ti ekspozohen prova, të dhëna dhe rrethana jo të rëndësishme dhe më pas ato më të rëndësishme, deri dhe prova materiale, shkresore dhe shkencore.

7.3.2 Tregimi i burimeve të provës duhet të bëhet vetëm atëherë, kur të siguroheni që ekspozimi i burimit të provës nuk do të dëmtojë hetimet e mëtejshme të procedimit penal.

8. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, në rastet, kur marrin në pyetje të dëmtuar ose deklarues që kanë dijeni për rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, si dhe kur u dorëzojnë mbrojtësve kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të hetimeve paraprake, **duhet ti sjellin në kujtesë dhe ti paralajmërojnë: - për detyrimin ligjor të ndalimit të publikimit nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv, qoftë dhe të pjesshëm të akteve ose të përmbajtjes së tyre; - për pasojat e rënda që mund të sjellë publikimi i akteve, si dhe; - për masat që mund të merren ndaj tyre në rastet e shkeljeve të ligjit¹³.**

9. Në rastet kur avokatët shkelin dispozitat ligjore të ndalimit të publikimit të akteve, në mbështetje të nenit 104 të K. Pr. Penale dhe neneve 9 pika 1, 22 e vijues të ligjit Nr. 9109 datë 17. 07. 2003 "Për profesionin e avokatit në R.Sh", prokurorët duhet ti kërkojnë Komitetit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe/ose Ministrisë të Drejtësisë, për të filluar procedimin disiplinor ndaj tyre.

¹⁰ Shih, po aty neni 279/2

¹¹ Shih, të gjithë punonjësit e policisë së shtetit në rolin e lartë dhe të mesëm, neni 5/1 i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".

¹² Shih, neni 14 pika 1 germa "a" e vijues të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore"

¹³ Shih, nenet 103 e 104 të K. Pr. Penale

10. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore duhet të marrin **masa të menjëhershme për të ndaluar kontaktet e papërshtatshme dhe jozyrtare me palët në procedim apo me çdo person të interesuar në zgjidhjen e çështjes**, me synim për të shmangur çfarë do lloj afere apo perceptimeve korruptive.

11. Fashikulli i gjykimit është i njëjtë për çdo rast, pavarësisht nga lloji i gjykimit.

11.1 Në rastin e gjykimit të shkurtuar në gjykatë nuk duhet të dërgohen edhe deklaratat e marra gjatë hetimeve. Ato nuk kanë asnjë vlerë derisa personat që i kanë lëshuar nuk pyeten në gjykatë. Kërkesa për gjykim të shkurtuar, bëhet nga i pandehuri pasi çështja ka shkuar në gjykatë dhe prokurori kur dërgon fashikullin e gjykimit nuk e di nëse i pandehuri do të kërkojë gjykim të shkurtuar.

11.2 Deklaratat mbahen në fashikullin e prokurorit dhe kur lind nevoja për administrimin e tyre, gjykata revokon vendimin për gjykimin e shkurtuar dhe zhvillon gjykimin e zakonshëm¹⁴.

12. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit, prokurorët dhe oficerët e agjentët e policisë gjyqësore të të gjithë niveleve, si dhe të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

13. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, përbën shkelje të disiplinës në punë.

14. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve të të gjithë niveleve, si dhe drejtuesit e tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU

Kon&Kom KL
5. 03. 07

¹⁴ Shih, për më tepër vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, F. Zyrtare nr. 24, viti 2003.